



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 262/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Kosovaki Nevi Romani Partia (KNRP) me seli në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia e Bashkuar Rome e Kosovës (PBRK) me seli në Prizren, për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Hidhet e palejuar ankesa e subjektit politik Kosovaki Nevi Romani Partia (KNRP) me seli në Prizren.

Arsyetim

Me datën 09.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik KNRP, në të cilën pretendohet se nga rezultatet preliminare të publikuara nga KQZ-ja, prezantimi i votave të prononcuara për subjektin politik PRBK në Prishtinë, Ferizaj dhe Pejë është shumë i vogël në krahasim me subjektin politik KNRP. Më tutje thekson se egzistojnë dyshime serioze për manipulime me rastin e numërimit të votave. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të rinumërohen votat e subjektit politik KNRP dhe PBRK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës gjeti se :

ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa e subjektit politik KNRP është e palejuar ngase rezultati preliminar i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoi në qdo moment prandaj ankesa është e pa lejuar duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 262/2014 më datën 12.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.